Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arkitektures, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit**
Programi:	**Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobilieve**
Titulli i lëndës:	**Matematikë dhe Statistikë**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**I**
Numri i orëve në javë:	**4**
Vlera në kredi – ECTS:	**7**
Koha/lokacioni:	**UShAF**
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Në kursin Matematikë dhe Statistikë do të studiohet fillimisht matematika elementare duke filluar nga nocionet themelore, algjebra lineare duke përfshirë edhe sistemet me dy e tri të panjohura, matricat e përcaktorët. Pastaj do të studiohet gjeometria dhe matja, gjeometria analitike. Do të përfshihet dhe një pjesë nga kuptimi i përqindjeve, pastaj vargjet, funksionet elementare dhe trigonometria. Kjo pjesë përfshinë rreth 70% të lëndës, ndërsa 30% do të jetë e koncentruar tek pjesa e Statistikës, ku do të fillohet me elementet themelore të statistikës, mënyrat e grumbullimit e përpunimit të të dhënave, karakteristikat e shpërndarjes.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij moduli është për të pajisur studentët me njohuri dhe aftësi për kuptimet themelore matematikore, gjeometrinë dhe matjen, gjeometrinë analitike, trigonometrinë e po ashtu edhe me disa elemente themelore të statistikës. Por, qëllimi kryesor është zbatimi i tyre ose lidhja me fushën e studimit të tyre, pra zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive të studentëve për të zgjidhur problemet konkrete të fushës së tyre të studimit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	*Pas përfundimit të suksesshëm të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje:*

	• Të kenë njohuri themelore konceptuale për rëndësinë e lëndës së Matematikës në Arkitekturë, • Të njohin dhe të kuptojnë elementet e algjebrës lineare në zgjidhjen e problemeve në fushën e Arkitekturës, • Të aplikojnë trigonometrinë në zgjidhjen e problemeve. • Të njohin konceptin e vargut dhe funksionit, llojeve të funksioneve, vetitë dhe zbatimet e tyre. • Të zbatojnë konceptet themelore të gjeometrisë. • Të njohin konceptet themelore të statistikës.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithësej**
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	0	0	0
Teste, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	25	50
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	3	9
Projektet, prezantimet, etj.	0	0	0
Totali			**175**

Metodologjia e mësimdhënies:	*Ligjërata dhe ushtrime të kombinuara dhe diskutime në klasë*

Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i njohurive të studentëve mbështetet në këto aktivitete: Vlerësimi i parë- 45 % Vlerësimi i dytë- 45 % Pjesëmarrja dhe angazhimi në orë: 10% Provimi përfundimtar: 90 % (për ata që nuk tregojnë rezultat të mirë në vlerësimin e parë dhe të dytë)
Literatura	
Literatura bazë:	1. Dr. Sc. Ajet Ahmeti, *Matematika për ekonomistë*, Prishtinë-2006. 2. Braha, N., 2006, *Bazat e Statistikës*, Prishtinë
Literatura shtesë:	1. Dr.Sc.Razim Hoxha, *Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga matematika I*, Prishtinë-2011 2. Dr.Sc.Xhevat Krasniqi, *Detyra të zgjedhura dhe të zgjidhura nga matematika 10,* Prishtinë 2014 3. Nuhiu, R. dhe Shala, A., 1995, *Bazat e Statistikës*, Prishtinë

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	**Ligjërata që do të zhvillohet**
Java e parë:	Nocionet themelore matematike: 1. Rregullat e veprimeve matematikore 2. Numrat dhe llojet e tyre 3. Bashkësitë dhe veprimet me bashkësi
Java e dytë:	Algjebra lineare: 1. Ekuacionet lineare me një të panjohur 2. Ekuacionet lineare me dy të panjohura 3. Inekuacionet 4. Vlera absolute
***Java e tretë*:**	Matricat dhe Përcaktorët 1. Kuptimi i matricave 2. Veprimet me matrica 3. Kuptimi i përcaktorëve (të rendit të dytë e të tretë)
Java e katërt:	Zgjidhja e sistemeve të ekuacioneve lineare me dy dhe tri të panjohura
Java e pestë:	Gjeometria dhe matja
***Java e gjashtë*:**	Gjeometria analitike
Java e shtatë:	Përqindjet:

	1. Kuptimi i përqindjeve 2. Llogaritja e përqindjeve *Vlerësimi i parë*
Java e tetë:	Vargjet numerike Limiti i vargut
Java e nëntë:	Funksionet me një ndryshore: 1. Format e paraqitjes së funksioneve 2. Funksionet elementare dhe grafiku i tyre
Java e dhjetë:	Trigonometria
***Java e njëmbëdhjetë*:**	Elementet themelore të statistikës matematike
***Java e dymbëdhjetë*:**	Përpunimi dhe paraqitja e të dhënave statistikore-mostrës
***Java e trembëdhjetë*:**	Karakteristikat e shpërndarjes empirike: mesi aritmetik, mesi gjeometrik, mesi harmonik. Moda, mediana.
***Java e katërmbëdhjetë*:**	Masat e dispersionit, kuartilet, devijimi mesatar absolut, varianca, devijimi standard, koeficienti i variacionit. Ekuacioni i regresionit dhe korrelacionit.
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	Përmbledhje *Vlerësimi i dytë*

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në diskutim gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme. Përdorimi i telefonit gjatë vlerësimeve është rreptësishtë i ndaluar.